

Draft fjalë për Seancën Plenare mbi

PROJEKT R E Z O L U T Ë N

**Për shpalljen e Republikës Islamike të Iranit si Shtet
Sponsor i Terrorizmit dhe Shtet që përdor mjete terroriste.**

I nderuar Zoti Kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot Kuvendi i Republikës së Shqipërisë diskuton një rezolutë,
të propozuar nga grupi i shumicës parlamentare,
që lidhet me një nga çështjet më të rëndësishme të sigurisë
ndërkombëtare dhe të rendit global:

**luftën kundër terrorizmit dhe përgjegjësinë e shteteve që e
mbështesin ose e tolerojnë atë.**

Terrorizmi nuk është vetëm një akt dhune.

Ai një strategji e qëllimshme frikësimi, destabilizimi dhe
minimi të rendit demokratik.

Ai godet civilët, godet institucionet dhe godet vetë parimet mbi
të cilat është ndërtuar sistemi ndërkombëtar pas Luftës së Dytë
Botërore.

Prandaj, lufta kundër terrorizmit nuk është thjesht një çështje sigurie.

Ajo është një betejë për mbrojtjen e demokracisë, për mbrojtjen e shtetit të së drejtës dhe për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit ndërkombëtar.

Shqipëria ka qenë dhe mbetet një vend i qartë dhe i palëkundur në këtë qëndrim.

Ne jemi një vend që ka zgjedhur qartësisht anën e demokracive,
anën e rendit ndërkombëtar të bazuar në rregulla dhe anën e bashkëpunimit ndërkombëtar kundër terrorizmit.

Si anëtar i NATO-s dhe si vend kandidat për Bashkimin Evropian,
Shqipëria ka jo vetëm të drejtën, por edhe detyrimin të kontribuojë në sigurinë kolektive të aleancës dhe të komunitetit ndërkombëtar.

Rezoluta që diskutojmë sot është pjesë e këtij angazhimi.

Ajo bazohet në një realitet që është dokumentuar në mënyrë të vazhdueshme nga analizat ndërkombëtare dhe nga raportet e institucioneve të sigurisë:

përdorimi i strukturave shtetërore, i organizatave të lidhura me to dhe i rrjeteve të ndërmjetme për të mbështetur grupe të armatosura, për të financuar aktivitete destabilizuese dhe për të ushtruar ndikim përmes mjeteve hibride në rajone të ndryshme të botës.

Një nga elementet më shqetësuese të këtij fenomeni është përdorimi i strukturave paramilitare dhe i grupeve të armatosura proxy që veprojnë si instrumente të politikës së jashtme.

Por për Shqipërinë kjo nuk është vetëm një çështje e largët gjeopolitike.

Vendi ynë ka qenë vetë objekt i sulmeve të drejtpërdrejta në hapësirën kibernetike.

Sulmi i rëndë kibernetik i vitit 2022 ndaj institucioneve të Republikës së Shqipërisë ishte një nga episodet më serioze të agresionit kibernetik ndaj një vendi sovran.

Ai synoi të paralizonte shërbimet publike, të dëmtonte funksionimin e institucioneve dhe të cenonte besimin e qytetarëve në shtetin e tyre.

Shumë përpjekje të tjera janë parandaluar ose zbuluar në kohë. Por kjo do të thotë se duhet të mbetemi vazhdimisht vigjilentë. Vetëm pak ditë më parë, një tjetër sulm shënjestroi pikërisht këtë institucion – Parlamentin e Republikës së Shqipërisë.

Këto nuk janë incidente të zakonshme teknologjike.

Këto janë akte armiqësore që synojnë destabilizimin e institucioneve demokratike dhe funksionimin e shtetit.

Rezoluta që diskutojmë sot synon pikërisht të adresojë këtë realitet.

Ajo dënon në mënyrë të qartë çdo formë të mbështetjes shtetërore për terrorizmin, dënon përdorimin e grupeve proxy për destabilizim dhe dënon përdorimin e mjeteve hibride – përfshirë sulmet kibernetike – kundër institucioneve të shteteve sovrane.

Rezoluta i bën thirrje qeverisë shqiptare që, në përputhje me legjislacionin tonë dhe në koordinim me aleatët tanë, të shqyrtojë shpalljen e Gardës Revolucionare të Iranit dhe organizatës Hezbollah në Liban si organizata terroriste, si dhe të forcojë bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë në luftën kundër terrorizmit të sponsorizuar nga shteti dhe rrjetet e tij.

Një numër i konsiderueshëm vendesh dhe institucionesh ndërkombëtare kanë ndërmarrë tashmë masa të ngjashme.

Shtetet e Bashkuara kanë shpallur Gardën Revolucionare Iraniane organizatë terroriste që në vitin 2019.

Në janar të këtij vitit, të njëjtën gjë bëri edhe Bashkimi European.

Ndërkohë, një numër vende europiane, përfshirë Gjermaninë, Francën, Mbretërinë e Bashkuar dhe të tjerë, kanë marrë masa konkrete përfshirë shpalljen si organizatë terroriste Hezbollahun.

Në këtë kontekst, qëndrimi i Shqipërisë është pjesë e një përpjekjeje të gjerë të komunitetit ndërkombëtar për të mbrojtur sigurinë kolektive dhe për të ndaluar përdorimin e terrorizmit si instrument të politikës shtetërore.

Të nderuar kolegë,

Kjo rezolutë nuk është një rezolutë kundër një populli.

Ajo nuk drejtohet kundër qytetarëve të Iranit, të cilët janë shpesh vetë viktima të një regjimi represiv.

Ajo është një qëndrim kundër praktikave shtetërore që mbështesin terrorizmin, destabilizimin dhe përdorimin e dhunës si mjet politik.

Shqipëria ka treguar vazhdimisht se është një partner i besueshëm në luftën kundër terrorizmit.

Kontributi ynë në NATO dhe në misionet ndërkombëtare është një dëshmi e qartë e këtij angazhimi.

Kjo rezolutë është një vazhdim logjik i këtij angazhimi.

Ajo është një mesazh i qartë se Shqipëria nuk toleron terrorizmin në asnjë formë dhe se institucionet e saj janë të vendosura të mbrojnë demokracinë, sigurinë dhe sovranitetin e vendit.

Për këto arsye, ju ftoj ta mbështesim këtë rezolutë, njëzëri.

Jo si një akt formal, por si një deklaratë të qartë të vlerave dhe përgjegjësisë sonë si një demokraci, si një aleat i NATO-s dhe si një vend që aspiron të jetë pjesë e Bashkimit European.

Ju faleminderit.